



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DORACAKU I LIGJEVE PËR KOMUNA

Publikimi i shtatë

Janar-Tetor /2012

Prishtinë

FJALA HYRËSE E Zv /KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TE ADMINISTRIMIT TE PUSHTETIT LOKAL

“ Doracaku i Ligjeve për Komunat”

Të nderuar,

Kam kënaqësinë që para juve të paraqes publikimin e shtatë të Doracakut të Ligjeve për Komunat, i hartuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Doracaku përfshinë ligjet që janë nxjerrur pas publikimit të Doracakut të gjashtë në gusht të vitit 2011.

Me publikimin e këtij doracaku synohet që të krijohet një pasqyrë e qartë për legjislacionin në fuqi përkatësisht ligjet bazë për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, ligjet tjera sektoriale, si dhe përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore që rrjedhin për organet komunale me këto ligje. Ky pasqyrim është i shkurtër dhe shërben si udhëzues - referencë për organet komunale, të cilat me rastin e vendosjes për çështje konkrete në kompetencë të tyre, të shtjellojnë në mënyrë përmbajtjesore ligjet.

Ky publikim është në vazhden e përmbushjes së përgjegjësiive mandatare të MAPL-së në raport me komunat dhe qytetarët, duke ofruar në vazhdimësi udhëzime komunave, për të lehtësuar dhe evituar sfidat e organeve të komunës në raport me punën e tyre në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme për qytetarët.

Përdorimi i Doracakut të Ligjeve për Komunat, Ju ofron lehtësime organeve Komunale përfshirë Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës, Komiteteve, si dhe zyrtareve komunal në nxjerrjen dhe harmonizimin e akteve komunale konform legjislacionit parësor. Gjithashtu, publikimi i këtij doracaku rezulton në mundësinë e shfrytëzimit të tij nga një spektër i gjerë i qytetarëve, zyrtarëve që punojnë në administratë komunale si dhe ekspertëve që merren me studimet dhe analizat krahasuese në fushën e qeverisjes lokale.

Shpreh bindjen e plotë se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të jetë në gjendje të ofroj asistencë të vazhdueshme në avancimin e qeverisjes lokale dhe përmes koordinimit më organet e komunave, të sigurojë shërbime më efektive dhe cilësore dhe sa më afër qytetarëve.

Me respekt,

Slobodan Petroviq,

Zv/ Kryeminister dhe Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNA
LIGJI PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILEN EKZISTON E DREJTA BANESORE

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L - 061
Hyrja në fuqi	21 dhjetor 2011
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-001/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	1 mars 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
----------------------------	--

Me këtë ligjë rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqrore dhe publike për të cilat egziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pa caktuar, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarja e së drejtës banesore.	Neni 1
Banesat, për të cilat është vërtetuar se shitësi i tyre është i panjohur, të drejtën e shitjes e bartë komuna në territorin e së cilës ndodhet banesa.	10.1
Bartësi i së drejtës banesore i parashtron kërkesë për blerjen e banesës organit të autorizuar të administratës komunale në territorin e së cilës gjendet banesa.	10.3
Organi komunal i autorizuar, pas përfundimit të procedurës së caktuar, aprovon kërkesën për blerjen e banesës së bartësit të së drejtës banesore i cili i ka plotësura kushtet e parapara me këtë ligj dhe nënshkruan kontratën brenda afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.	10.4
Komuna përcakton se cilat banesa bëjnë pjesë në administrative ose reprezentative sipas nenit 11 të këtij ligji. Komuna me kërkesën e personit të interesuar vërteton se cilat banesa janë ngritë ose blerë nga mjetet e dhëna ose të mbedhura për qëllime bamirësie ose qëllime tjera me interes publik sipas nenit 11 të këtij ligji.	12.1 12.2
Zyra Kadastrale e Komunës i regjistron të drejtat e pronave të paluajtshme në regjistër sipas autorizimit të Agjencionit të Kadastrës të Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi.	23.4
Në komunat ku nuk është themeluar regjisitri i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e drejta e hipotekës fitohet me regjistrimin e kësaj të drejte në një regjistër tjetër adekuat për regjistrimin e të drejtës së pengut mbi pronën e paluajtshme. Mjetet e realizuara nga shitja e banesave paguhen në buxhetin e komunës kur bartës i të drejtës së disponimit janë komunat.	25.2 28.2.1



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR RREGULLIMIN E TOKËS

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-040
Hyrja në fuqi	23 janar 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-002/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	07 mars 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
----------------------------	--

	Neni
Ky ligj rregullon bazën ligjore për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha dhe rregullimin e tokave bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore në funksion të shfrytëzimit më racional dhe më ekonomik gjithashtu përcaktohen përgjigjësit e institucioneve që janë kompetente për rregullimin e tokës, procedurat për rregullimin e tokës, planifikimin, financimin dhe zbatimin e këtij procesi.	I
Ministria në harmoni me Planin zhvillimor komunal propozon zonat kadastrale apo pjesët e zonave kadastrale të cilat do të rregullohen me projektin e rregullimit të tokës. Rregullimi i tokës nga paragrafi I i këtij neni nuk mund të zbatohet nëse nuk është miratuar plani hapësinor i komunës.	5.1 5.2
Komisioni për rregullimin e tokës është përgjegjës për tërë projektin e rregullimit të tokës, hartimin e planve, zbatimin dhe të gjitha procedurat të tjera përkatëse. Institucionet që e mbështesin Komisionin për rregullimin e tokës janë:	7.3 8.1
- Ministria,	8.1.1
- Agjencioni Kadastral i Kosovës,	8.1.2
- Komuna, dhe	8.1.3
- Zyra kadastrale komunale.	8.1.4
Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Zyra Kadastrale Komunale siguron të dhënat e nevojshme në pajtim me Ligjin për Kadastër dhe mbështesin Komisionin në përpilimin e projektit për rregullimin e tokës ndërsa komuna ofron ndihmë teknike administrative komisionit për rregullimin e tokës.	8.2 8.3
Kërkesa për zbatimin e rregullimit të tokës parashtrohet nga komuna në territorin ku gjendet masa për rregullimin e tokës. Miratimi i kërkesës për rregullimin e tokës shpallet në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në tabelen e shpalljeve të Kuvendit Komunal.	10.1.2 10.6



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR RREGULLIMIN E TOKËS

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-040
Hyrja në fuqi	23 janar 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-002/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	07 mars 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
----------------------------	--

	Neni
Shqyrtimi publik i projektit shpallet në gazetën ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të komunës ku ftohen të gjithë pjesëmarrësit për të dhënë komentet ose ndryshimet e tyre për propozim projektin.	12.2
Sqarimi i pronësisë në gjendjen faktike bëhet me procedurë vijuese :	34
- Komisioni për rregullimin e tokës ka për detyrë të përpilojë listën e pronësisë së identifikuar. Operatori ekonomik mbledh të gjitha të dhënat relevante në Zyrën Kadastrale Komunale, dhe nëse nevojiten dokumente të tjera si dokumente të pronësisë, harta gjeodezike, fotografitë ajrore dhe informata nga terreni.	34.1
Pasi të jetë përpiluar lista e pronësisë së identifikuar, komisioni për rregullimin e tokës e paraqet listën për shqyrtim publik gjatë tridhjetë (30) ditëve për të mbledhur komentet e pjesëmarrësve. Shqyrtimi publik i listës shpallet në gazetën ditore , si dhe në tabelën e shpalljeve në komunë.	34.1.1 34.1.3
Në komunat në të cilat nuk është nxjerr Plan i Zhvillimit, deri në nxjerrjen e tij, rregullimi i tokës mund të zbatohet në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës me të cilin janë përcaktuar destinimet themelore të sipërfaqeve të tokës në masën e rregullimit.	38



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT LIGJI PËR POLICINË

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-076
Hyrja në fuqi	02 mars 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-003/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	17 prill 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Punëve të Brendshme
----------------------------	--

	Neni
Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës (PRK), organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e PRK.	I
Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale.	7.1
Policia bashkëpunon me komunitetin, ndërkaq komandanti i stacionit dhe përfaqësues të tjerë policorë marrin pjesë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, të themeluar në secilën komunë. Këshilli për siguri në bashkësi është një organ këshillues i kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda komunës.	7.2 7.3
Drejtori i përgjithshëm është i autorizuar të themeloj Komitetin për Siguri Publike, si një organ këshillues në kuadër të ndonjë zone të caktuar në çdo komunë që është në interesin më të mirë për një punë efektive të policisë në bashkësi.	7.5
Me kërkesë të institucioneve të qeverisjes lokale, policia është e autorizuar t'ju ofrojë ndihmë në kryerjenë e detyrave publike, kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose e personave që kryejnë detyra publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm ndaj veprimeve të tyre.	8.2
Policia e Republikës së Kosovës organizohet:	32.1
<ul style="list-style-type: none">- në nivel qendror; dhe- në nivel lokal.	
Në nivelin lokal përfshinë Drejtorit Rajonale të Policisë, përgjegjëse për rajonet e përbëra me komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilën komunë dhe nënstationet policore, përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune. Juridiksioni territorial i secilës Drejtori rajonal përcaktohet nga Drejtori i përgjithshëm brenda kufijve të komunës ku është vendosur. Gjithashtu edhe juridiksioni territorial i secilit nënstation policor përcaktohet nga Drejtori i përgjithshëm.	32.2
Me qëllim të menaxhimit dhe kontrollit të kufijve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, përveç stacioneve policore që gjenden në secilën komunë, themelon edhe stacione kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e Drejtorisë rajonale të policisë kufitare.	32.4



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR POLICINË

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-076
Hyrja në fuqi	02 mars 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-003/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	17 prill 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Punëve të Brendshme
----------------------------	--

Neni

- Stacionet policore themelohen në secilën komunë, ndërsa juridiksioni territorial i stacionit policor është i njëjtë me kufijtë e komunës të përcaktuar me ligj. 35.1
- Stacionet policore kryejnë detyra policore brenda territorit komunal. Secilin stacion policor e udhëheq komandati i stacionit. 35.2
- Drejtori Rajonal mund t'ia propozojë për miratim Drejtorit të Përgjithshëm, themelimin e nënstacioneve policore njëjse të tjera organizative në kuadër të stacioneve policore. 35.3
- Përbërja etnike e policisë në kuadër të komunës, deri në nivelin e mundshëm, do ta përfaqësojë përbërjen etnike të popullatës të asaj komune. 35.4
- Në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve i emëron Ministria e Punëve të Brendshme me propozimin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorit të përgjithshëm, në pajtim me dispozitat e këtij neni. 42.1



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR SHËRBIME KËSHILLUESE PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM
RURAL

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-074
Hyrja në fuqi	15 shkurt 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-004/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	17 prill 2012

Ministria Përkatëse | **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Neni

Me këtë ligj rregullohet organizimi dhe zbatimi i aktiviteteve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural si njohurit e përgjithshëm të fermerëve, trajnimin e tyre për të menaxhuar fermën, rritjen e të ardhurave në fermë, mbështetje në zgjidhjen e problemeve që lidhen me prodhimin, çështjet ekonomike dhe organizative për zhvillimin e fermave, ruajtjen e burimeve natyrore, mjedisit, përcjelljen e të arriturave dhe trendët në BE, duke u bazuar në kërkesat e tregut.

I

Shërbimet këshilluese publike janë të organizuara në:

5.1

- nivel qendrorë, dhe
- nivel lokal;

5.1.2

5.1.3

Shërbimet këshilluese në nivel komunal për bujqësi dhe zhvillim rural janë të organizuara në komunë sipas kriterëve të përcaktuara me akt nënligjor të përcaktuar nga Ministria.

7.1

Secila komunë duhet të ketë nga një pikë kontaktuese e cila shërben si qendër informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural për marrjen dhe përcjelljen e këshillave dhe informatave për fermer dhe komunitetin.

7.2

Secila komunë duhet ti ketë këshilltarët e saj për bujqësi dhe zhvillim rural që i mbulojnë kërkesat sipas ligjit. Shërbimet këshilluese komunale janë përgjegjëse për detyrat e përcaktuara me këtë ligj si dhe duhet ti përmbahen rregullave dhe metodave të përcaktuara me këtë ligj.

7.3

7.4



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR ARKIVAT SHTETËRORE

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-088
Hyrja në fuqi	15 shkurt 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-005/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	17 prill 2012

Ministria Përkatëse	Zyra e Kryeministrit
----------------------------	-----------------------------

Neni

Me këtë ligj përcaktohen rregullat bazë për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor në institucionet e Republikës së Kosovës.

I

Arkivat lokale administrojnë, ruajnë, mbrojnë, klasifikojë dhe kategorizojnë materialet arkivore të institucioneve lokale dhe të organeve që veprojnë brenda njësisive administrativo-territoriale përkatëse. Ato kontrollojnë dhe i ofrojnë ndihmë profesionale fond krijuesit të institucioneve të pushtetit lokal.

16.1

Materiali arkivor dorzohet në arkivin kompetent në kuadër të Agjencisë shtetërore pas kalimit të afatit të përcaktuar me këtë ligj i regjistruar dhe i evidentuar në pajtim me rregullat dhe standartet e arkivistikës.

16.2



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E LIGJIT NR.2003/15 PËR
SKEMËN E NDIHMËS SOCILAE NË KOSOVË

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-096
Hyrja në fuqi	10 maj 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-006/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
----------------------------	---

Neni

Me këtë ligj përcaktohen rregullat e skemës së ndihmës sociale në Kosovë me qëllim të mbështetjes dhe ofrimit të ndihmës së përkohshme financiare për familjet që janë në varfëri.

I

Shërbimet e ndihmës sociale brenda qendrave për punë sociale, të caktuara për të administruar skemën e ndihmës sociale, menaxhohen nga udhëheqësi i shërbimit të ndihmës sociale, i cili zgjedhet nga komuna, në bashkëpunim me Ministrinë.

3.2

Udhëheqësi i skemës së ndihmës sociale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë, i përgjigjet drejtorit/drejtorisë përkatëse në komunë dhe i rapoton Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale.

3.3.3

Ministria në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda të administrimit të skemës së ndihmës sociale, mund ta marrë në administrim të drejtpërdrejtë skemën e ndihmës sociale në atë komunë, për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit.

3.3.4



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT LIGJI PËR BIBLIOTEKAT

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-097
Hyrja në fuqi	06 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-007/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit
----------------------------	--

Neni

Me këtë ligj përcaktohen parimet dhe normat themelore të veprimtarisë bibliotekare dhe të organizimit dhe funksionimit të bibliotekave.	I
Kushtet dhe kriteret për themelimin dhe funksionimin e bibliotekave përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria përkatëse për Kulturë në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për Arsimit dhe asociacionin e Komunave të Kosovës.	4.2
Llojet e bibliotekave janë:	5.1
- bibliotekat publike; dhe	5.1.1
- bibliotekat private.	5.1.2
Në bibliotekat publike bëjë pjesë:	5.2
- biblioteka kombëtare e Kosovës;	5.2.1
- biblioteka komunale;	5.2.2
- biblioteka universitare;	5.2.3
- bibliotekat shkollore; dhe	5.2.3
- bibliotekat e veçanta.	5.2.4
-Biblioteka komunale themelohet në çdo komunë si institucion kulturor arsimor me vendim të Kuvendit të Komunës. Është institucion kyç për koleksionimin, ruajtjen dhe propagandimin e kulturës në vendin ku vepron. Ajo siguron qasje të lirë në dije të informacionit dhe ofron shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët. Gjithashtu bibliotekat krijojnë katalog dhe siguron informacion të materialeve bibliotekare me karakter historik, kulturor dhe shkencor. Staf i profesional i bibliotekës përzgjedhet në përputhje me përgatitjen profesionale bibliotekare.	18.1 18.2 18.5 18.8
Biblioteka komunale mund të themelojë degët e veta në lokalitete sipas kërkesave dhe mundësive buxhetore	18.7
Financimi i bibliotekave komunale bëhet nga buxheti i komunës. Ndërsa Ministria përkatëse për Kulturë, nga buxheti i vetë përmes konkursit vjetor për projekte, financon projekte të bibliotekave komunale me fondin prej pesë përqind (5%) të buxhetit të përgjithshëm vjetor të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.	13.2 13.2.1



**MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR BIBLIOTEKAT**

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-097
Hyrja në fuqi	06 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-007/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit
----------------------------	--

Neni

- Për realizimin e qëllimeve të përbashkëta dy ose më shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në mardhënie bashkëpunimi në fushën e bibliotekarisë për dhënie të ndihmës së ndërsjellë njëra-tjetrës dhe plotësimin e veprimtarisë së tyre me koleksione, huazime dhe falje të materialeve bibliotekare. 18.9
- Komunat e përfshira në cilat do forma të bashkëpunimit ndërkomunal veç e veç dhe bashkarishtë mbajnë përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet juridike që rezultojnë nga bashkëpunimi në fjalë. 18.10
- Ministria përkatëse për Kulturë mund të propozojë marrëveshje me dy ose shumë komuna për caktimin e bibliotekës që do të kryej funksionin e bibliotekës koordinuese të përcaktuar në bazë të marrëveshjes. 18.11



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT LIGJI PËR TEATROT

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-106
Hyrja në fuqi	24 maj 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-008/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
----------------------------	---

Neni

Me këtë ligjë garantohen të drejtat dhe liritë krijuese për të gjitha format dhe shprehjet artistike skenike dhe njëkohësisht rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, drejtimin, menaxhimin dhe financimin e teatrove, pozitën e artistëve teatrorë dhe çështjet të tjera të rëndësishme për teatrot.

I

Teatrot me status publik janë :

- teatrot kombëtarë;
- teatri i qytetit; dhe
- teatri i studentëve të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës.

5.1

5.1.1

5.1.2

5.1.3

Teatrot e qyteteve themelohen me vendim të Asamblesë Komunale. Komuna nuk mund të themelojë më shumë se një teatër të qytetit me status publik. Teatri i qytetit mund të ketë ansamblin rezident prej së paku dhjetë (10) dhe me se shumti njëzet (20) aktorë. Statutin e qytetit e harton Këshilli drejtues dhe me propozim të Kryetarit të Komunës e miraton Asambleja Komunale.

4.3

7.6

7.9

Këshilli drejtues i teatrit të qytetit përbëhet nga pesë (5) anëtarë, me mandat katër (4) vjeçar, njëri prej pesë (5) anëtarëve të Këshillit drejtues të teatrit të qytetit duhet të jetë përfaqësues i komunës përkatëse. Anëtarët e këtij këshilli duhet të jenë persona kredibil, me autoritet dhe me përgatitje profesionale në fushën e teatrit.

11.3

11.4

11.5

Këshillin drejtues të teatrove të qytetit e emëron dhe shkarkon Kryetari i Komunës.

11.6

Konstituimin e Këshillit drejtues të teatrove të qytetit e bënë Kryetari i Komunës. Ky këshillë i paraqet Kryetarit të Komunës së paku një (1) herë në vit raportin e punës së teatrit.

11.7

11.11

Nëse teatrot e qyteteve pushojnë së funksionuari kostumet, elementet skenografike, rekuizitat e shfaqjeve dhe materiale tjera kalojnë në pronësi të komunës. Mbikëqyrjen e funksionimit dhe menaxhimit të teatrove të qytetit e bënë Komuna përkatëse.

22.2

23



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR Nr.04/L-100 NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR
TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME Nr.03/L-204

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-100
Hyrja në fuqi	20 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-009/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Financave
----------------------------	------------------------------

Neni

- Me këtë ligjë bëhet ndryshimi i normës për pagesën e tatimit në pronën e paluajtshme dhe procedurës së ankimit. I
- Kuvendi komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën tatimore prej zero pikë pesëmbdhjetë (0.15 %) deri një përqind (1%) të vlerës së pronës në treg. 7.1
- Prona e papërfunduar është prona në ndërtim e sipër, që nuk i plotëson kushtet për shfrytëzim normal dhe që do të vlerësohet dyzet përqind (40%) e vlerës së pronave rezidenciale dhe me normë të tatimit të po këtyre pronave. 7.2
- Për çdo vit fiskal, tatimi komunal mbi pronën e paluajtshme paguhet në dy (2) këste të barabarta me ose para 30 qershorit dhe 31 dhjetorit të vitit tatimor. 15.1
- Tatimpaguesi, i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Bordi Komunal, mund të ushtroj ankesë brenda tridhjet (30) ditëve nga data e pranimit të vendimit nga Bordi komunal. 4.1
- Nëse Bordi Komunal nuk ka marr Vendimin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita në të cilën ankesa ishte dorzuar, tatimpaguesi mund të ushtrojë ankesë në mënyrë të drejtpërdrejt në organet e përcaktuara pra në Bordin Komunal. 4.2



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI Nr.04/L-I PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
Nr.03/L-087 PËR NDERMARRJET PUBLIKE

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-111
Hyrja në fuqi	20 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0010/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
----------------------------	--

Neni

Me këtë ligjë rregullohet korniza ligjore lidhur me pronësinë e ndërmarrjeve publike dhe qeverisjen e tyre korporative në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisje korporative të ndërmarrjeve publike.

I

Komunat kanë të drejtë për të krijuar ndërmarrje publike lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me akt nënligjor të Qeverisë. Kriteret duhet të përfshijnë kërkesa të arsyeshme për qëndrueshmëri operationale dhe financiare.

6.11.3

Pjesëmarrja e komunave në bordet e ndërmarrjeve rajonale të ujit është:

8.15.14

- në bordet e Drejtorëve të secilës ndërmarrje të ujit, Qeveria duhet të emërojë të paktën gjysmën e drejtorëve nga kandidatët e nominuar nga komunat ku ofron shërbimet ndërmarrja rajonale e ujit; (a)
- komunat përkatëse duhet ti dorëzojnë Qeverisë një numër kandidatësh të cilët i përmbushin kriteret e përcaktuara me këtë ligj, numër i cili duhet të jetë të paktën tre (3) me shumë se numri i pozitave të hapura për drejtor të rezervuar për përfaqësues të komunave; (b)
- nëse komunat përkatëse nuk nominojnë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për të shërbyer si Drejtor, komunat do të kenë një rast shtesë që pas gjashtë (6) muajve të dorëzojnë emra të ri të kandidatëve të përshtatshëm në ndërkohë Qeveria mund të emëroj përkohësisht një drejtor të kualifikuar; (c)
- nëse komunat nuk nominojnë kandidatë të përshtatshëm për zgjedhje brenda afatit prej gjashtë (6) muajve, Qeveria emëron Drejtorin e kualifikuar që të shërbejë për pjesën e mbetur të madatit; (d)
- proceduar e nominimit dhe zgjedhjes së kandidatëve të komunave duhet të përcaktohet me një akt nënligjor të lëshuar në pajtim me këtë ligj. (e)

Zyrtarët e secilës ndërmarrje publike deri me datën 31 tetor të çdo vit kalendarik duhet të përgatisin planin e biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik në pajtueshmëri me politikat zhvillimore të sektorit që i bënë Ministria e linjës dhe në përputhshmëri me planet zhvillimore komunale. Ky planë duhet që së pari ti dorëzohet për miratim Bordit të Drejtorëve, pas miratimit, plani afarist i dorëzohet për qëllime të informimit vetëm sipas rastit Ministrit ose Komisionit(eve) përkatëse komunale të aksionarëve.

17.30.1

Raportet vjetore dhe tre mujore në formë të informatës i dërgohen edhe Kryetarit të Komunës në të cilën e ushtron veprimtarinë ndërmarrja publike, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

18.31.6



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-066
Hyrja në fuqi	20 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0011/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
----------------------------	--

Neni

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashigimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

1

Qendra e mbrojtur historike e Prizrenit, si pronë e trashigimisë kulturore në mbrojtje përfshihet në listën e trashigimisë kulturore, në mbrojtje të përhershme të Republikës së Kosovës.

4.2

Komuna e Prizrenit në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, harton, miraton dhe zbaton dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urbanistik që kanë të bëjnë me qendrën historike të Prizrenit në pajtim me Ligjin për planifikim hapësinor, Ligjin për ndryshim-plotësimin e Ligjit për planifikim hapësinor dhe Ligjin për trashigimi kulturore.

5.1

Gjdo ndërhyrje në infrastrukturën e Qendrës historike të Prizrenit, duke përfshirë: ujësjellësin, kanalizimin, rrjetin telefonik, rrjetin elektrik, apo rrjetet tjera të infrastrukturës bëhenë pas miratimit të Projektit zbatues nga Drejtoria për Urbanizëm dhe pëlqimit nga Instituti për Mbrojtje të Monumenteve të Prizrenit.

8

Me qëllim të ruajtjes së monumenteve dhe tërë Qendrës Historike të Prizrenit, Komuna harton planin e menaxhimit të mbeturinave për këtë qendër në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, gjithashtu komuna harton edhe planin kundër zjarrit, fatëkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

11
13

Këshilli për trashigimin kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit duhet të themelohet nga Komuna e Prizrenit brenda katër (4) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve:

14.1

- një (1) anëtarë nga Bashkësia Islame; 14.1.2.1
- një (1) anëtarë nga Kisha Ortodokse Serbe; 14.1.2.2
- një (1) anëtarë nga Kisha Katolike; 14.1.2.3
- së paku dy (2) anëtarë nga shoqëria civile që janë ekspert të njohur nga fusha e trashigimisë kulturore; dhe 14.1.2.4
- një anëtarë nga zyra komunale përgjegjëse për komunitete dhe kthim. 14.2

Roli i këtij kshilli është të vëzhgojë dhe këshilloj rreth aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT LIGJI PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-066
Hyrja në fuqi	20 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0011/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 korrik 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
----------------------------	--

	Neni
Anëtarët e këshillit emërohen prej Kuvendit të Komunës për periudh (tre) 3 vjeçare, përmesë procedurës e cila përfshinë ftesën publike duke i përcaktuar kushtet për konkurim dhe antarësim.	14.5
Kryesuesi i këshillit duhet të zgjidhet me votim të fshehtë nga shumica e anëtarëve të këshillit. Këshilli takohet së paku një herë në çdo tre muaj dhe publikon punën e tij me informatë publike dhe për këtë punë i raporton Kuvendit Komunal.	14.7 14.8
Shkarkimi i anëtaritë të këshillit, bëhet nga Kuvendi i Komunës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Komunës ose me propozim të Kryesuesit të komitetit, nëse tri herë radhazi pa arsye të vlefshme nuk ka marr pjesë në mbledhje të këshillit.	14.10
Drejtoria për Urbanizëm përpilon në baza vjetore listën e kërkesave të pranura për projekte, dhe i dorëzon Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit dhe kryesuesit të këshillit për Trashigimi Kulturorë për leje urbanistike, ndërtim, rrënim apo ndryshim të objekteve, zhvillim të aktiviteteve të përkohshme apo çfarëdo zhvillimi tjetër brenda Qendrës Historike të Prizrenit.	15.1 16.1
Këshilli duhet të konsultohet me pronarin nëse prona e tij/saj preket nga kërkesa e projektit me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me Kushtetuten dhe ligjet në fuqi për pronën.	16.3
Komuna e Prizrenit, në kuadër të fushëveprimit të saj themelon një Zyre për Qendrën Historike të Prizrenit me qëllim të:	21
- kordinimit të veprimeve që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë asistencën ndërkombëtare;	21.1
- informimit të publikut mbi rëndësin e statusin e mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit;	21.2
- promovimit dhe zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashigimi kulturor të pasur;	21.3
Zyra e Qendrës Historike e Prizrenit punon në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët përkatëse të interesit, përfshirë Këshillin, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, Shoqatën e Biznesit, Zyrën Komunale për Komunitete, Komunitetet fetare dhe organizatat tjera të shoqërisë civile.	21.3



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT LIGJI PËR FSHATIN HOÇË E MADHE

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-062
Hyrja në fuqi	20 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0012/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 gusht 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
----------------------------	--

	Neni
Qëllimi i këtij ligji është caktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të fshatit Hoçë e Madhe si pronë e trashigimisë kulturore dhe fetare në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur.	I
Këshillin e themelon Kuvendi i Komunës në pajtim me nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Këshilli përfaqëson interesat e fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashigimisë fetare dhe kulturore dhe në fushën e planifikimit rural.	4.2 4.1
Këshilli përbëhet prej pesë (5) anëtarëve:	
- dy (2) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Komunës;	4.3
- dy (2) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejt nga banorët e fshatit Hoçë e Madhe;	4.3.1
- një (1) anëtarë zgjidhet nga Kisha ortodokse serbe, i cili duhet të jetë anëtarë i fshatit Hoçë e Madhe;	4.3.2 4.3.3
Zgjedhja e Këshillit organizohet nga Kuvendi i Komunës përmes ftesës publike në pajtim me legjislacionin në fuqi. Anëtarët e Këshillit zgjedhën me mandatin e njëjtë të anëtarëve të Kuvendit të komunës me të drejtë rizgjedhje. Buxheti për themelimin dhe funksionimin e Këshillit ndahet në pajtim me Ligjin mbi Financat Lokale, i cili i ofrohet komunës si grand për kompetencat e shtuara.	4.4 4.5 4.10
Komuna ose autoriteti i shqyrtojnë kontributet, vlerësimet dhe propozimet/rekomandimet e këshillit siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.	5.1
Këshilli ka të drejtë, që në konsultim dhe në bashkëpunim me organin kompetent të komunës të ushtrojë autoritete të kufizuara në aktivitete e fushës së planifikimit rural përmes:	7.1
- pjesëmarrjes në hartimin e dokumenteve të planifikimit rural të fshatit; dhe	7.1.1 7.1.2
- pjesëmarrjes në hartimin e planit zhvillimor komunal (PZHK);	
Me qëllim të ruajtjes së stukturës dhe karakteristikes së veçantë të fshatit me planin e konservimit, ndalohen përkatësisht kufizohen këto aktivitete:	8.1
- ndërtimi apo zhvillimet industriale, siç janë kërkimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerare dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit;	8.1.1 8.1.2
- ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin ose ndotjen e mjedisit;	8.1.4
- urbanizimi i tokës bujqësore;	
- ndërtimi i pompave të benzinës;	8.1.5
- vendosja e ekspozimeve të përhershme reklamuese, tabelave private, dekorimeve ose elementeve të tjera penguese me sipërfaqe më të madhe se 1m ² .	8.1.9



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR FSHATIN HOÇË E MADHE

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-062
Hyrja në fuqi	20 prill 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0012/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	06 gusht 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
----------------------------	--

- Përveç kushteve për dhënie të lejeve që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi, procedura për dhënien e kërkesave për leje në Zonën e veçant të mbrojtur (ZVM) e Fshatit Hoçë e Madhe përfshin edhe ndërmarrjen e këtyre veprimeve:
- Neni**
- 9.1
 - komuna i dorëzon Këshillit të gjitha kërkesat e shqyruara për leje brenda ZVM-së me rekomandimet e saj profesionale; 9.2
 - këshilli shqyrton të gjitha rekomandimet për leje në përputhje me ligjet në fuqi; 9.3
 - këshilli mund të mos pajtohet me një rekomandim për leje vetëm nëse konsideron se ajo nuk është në përputhje me planet hapësinore dhe urbane dhe ligjet në fuqi; 9.4
 - këshilli shqyrton rekomandimet për leje dhe informon komunën për pëlqimin ose refuzimin nga ana e tij brenda 15 ditësh dhe nëse Këshilli nuk përgjigjet konsiderohet se rekomandimi i Komunës ka marrë pëlqimin nga Këshilli. 9.5



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT LIGJI PËR MBETURINA

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-060
Hyrja në fuqi	24 maj 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0013/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	28 gusht 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
----------------------------	--

	Neni
Qëllimi i këtij ligji është evitimi dhe reduktimi sa më i madh i gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.	1
Ekzistojnë këto lloje të mbeturinave:	6.1
- mbeturinat komunale;	6.1.1
- mbeturinat komerciale;	6.1.2
- mbeturinat industriale;	6.1.3
- mbeturinat medicinale;	6.1.4
Një ndër dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave është edhe plani komunal të cilin e nxjerr Komuna për periudhë kohore prej pesë (5) vitesh dhe e revidon sipas nevojës, mirpo ky plan duhet të jetë i harmonizuar me planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave.	8.1.3 8.2 10.5
Sipas nevojës dhe në marrëveshje, dy ose më shumë komuna mund të nxjerrin planin e përbashkët për menaxhimin e mbeturinave.	10.3
Përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e këtij ligji janë:	15.1
- krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave;	15.1.1
- plani komunal i menaxhimit të mbeturinave duhet të jetë i harmoni me planin nacional;	15.1.2
- përgjegjës për zbatimin e planeve komunale janë Komunitet;	15.1.3
- të hartojn raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave dhe duhet ta dorëzojnë në MMPH, deri me 31 mars të vitit vijues;	15.1.4
- mirëmbajtja dhe përkujdesja për sistemin e informimit të publikut dhe raportimit për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe akte tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave ;	15.1.6
- komuna cakton tarifën për deponimin e mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;	14.3 15.1.8
Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal mjedisor.	15.3
Komuna është e detyruar të siguroj largimin dhe përkujdesjen e mbeturinave të cilat janë hedhur në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave në territorin e saj.	15.5
Komuna nxjerr akte nënligjore me të cilat rregullon funksionimin e organit kompetent komunal dhe standartet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave.	15.7



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT
LIGJI PËR MBETURINA

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-060
Hyrja në fuqi	24 maj 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0013/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	07 shtator 2012

Ministria Përkatëse	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
----------------------------	--

	Neni
Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me përgjegjësit ligjore nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur, përgjegjësini për ato mbeturina e bartë komuna.	15.6
Mbeturinat komunale të përziera me mbeturina të rrezikshme, duhet të ndahen kur egziston llogaria ekonomike, në të kundërtën konsiderohen mbeturina të rrezikshme.	34.3
Amvisritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale detyrohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara për grumbullimin e mbeturinave komunale, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to.	34.4
Komunat janë të detyruara të organizojnë sistemin për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme.	34.5
Gjithashtu, Komunat me akt të veçantë, rregullojnë sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, orarin për mbledhjen e mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontenjerëve për mbeturina, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrat për transportim të mbeturinave komunale	34.7
Menaxhimi i mbeturinave komunale nga komunat duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat të licencuar për menaxhimin e mbeturinave.	34.8
Inspektori mjedisor komunal mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës përkatëse, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuar sipas këtij ligji.	66.1



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNAT LIGJI PËR NDËRTIM

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L-110
Hyrja në fuqi	31 maj 2012
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-0014/12
Data e Udhëzuesit në Doracak	07 shtator 2012

Ministria Përkatëse | **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

Neni

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kornizës ligjore e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejës ndërtimore duke përfshin të gjitha objektet ndërtimore në Kosovë dhe lëshimin e çertifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës.

I

Komunat lëshojnë leje ndërtimore për kategorit (I) ku përfshihen ndërtimet me rrezikshmëri të ulët dhe (II) ku përfshihen ndërtimet me rrezikshmëri të mesme të ndërtimeve. Sipas marrvëshjes së dy apo më tepër komunave në përputhje me ligjin e aplikueshëm, komunat mund të formojnë një strukturë të përbashkët që do të kishte përgjigjësi për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore dhe koordinimin e inspektimeve ndërtimore.

19.2

Detajet e ndërtimeve për të cilat nuk kërkohet leja ndërtimore përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria në bashkëpunim me Komunat.

16

Komuna mund të vlerësojë një ngarkesë për aplikuesin për të rimbursuar koston e krijimit, përmisimit, zgjerimit apo riparimit të infrastrukturës komunale vetëm aty ku është e autorizuar për të bërë këtë sipas nenin 17 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Nëse komuna propozon të vlerësojë një taksë infrastrukturore, me kërkesë të aplikuesit komuna do të bëjë një Marrëveshje Zhvillimi me aplikuesin në mënyrë që të specifikojë afatet, kushtet dhe orarin sipas të cilit taksa infrastrukturore do të paguhet. Marrëveshja për Zhvillim mund të specifikojë shumën dhe afatet brenda të cilave aplikuesi do ta rimbursojë komunën ose ndryshe mund të specifikoj kushtet mbi të cilat aplikuesi do të ndërmarrë sigurimin e infrastrukturës në lidhje me pagesën e taksës së infrastrukturës. Marrëveshja për Zhvillim do të përmendet në lejen e ndërtimit dhe do të regjistrohet së bashku me pronën e subjektit në Drejtorinë për kadastër dhe Gjeodezi të Komunës.

23

Funksionimin e inspektimit të parapar me këtë ligj dhe akte tjera e kryen Inspekcioni ndërtimor i Ministrisë dhe Inspekcioni ndërtimor i Komunave brenda kompetencave të tyre.

29